



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË
KOORDINATOR I KONSULTIMIT PUBLIK

Nr. 1162/14 Prot.

Patos, më 14/05/2026

PROCESVERBALI I TAKIMIT 12 MAJ 2026

Vendi: Gjy노qarë

Ora e fillimit: 10:00

Ora e mbarimit: 10:30

Dëgjesë publike me temë: “Zhvillimi i zonave prioritare për aplikimin Paketa e Maleve”.

Baza Ligjore: Në zbatim nenit 18 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjit nr. 146/2012 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, Rregullores së Këshillit Bashkiak “Për konsultimin publik”, si dhe kërkesës me nr. 1162 prot, datë 01.04.2026 të drejtorisë së Zhvillimit të Territorit dhe Emergjencave Civile për zhvillimin e dëgjesës publike me temë: Zhvillimi i zonave prioritare për aplikimin në “Paketën e Maleve”.

Pjesëmarrës: Kryetar i Këshillit Bashkiak, Kryetar i Bashkisë Patos, z. Fation Duro, Zv/Kryetar znj. Ina Sauli, Sekretare e Këshillit znj. Refaela Xeba, Sekretare e Përgjithshme znj. Juela Shpata, Drejtore znj. Boreta Murati etj., me pjesëmarrjen e **13 pjesëmarrësve** (banorë, kryetar i fshatit Gjy노qarë, përfaqësues të bashkisë Patos etj)

Takimin hapet nga Kryetar i Këshillit Bashkiak, z. Armand Ahmetaj- Të nderuar të



**Kryetar i Këshillit Bashkiak
z. Armand Ahmetaj**

**Dëgjesë publike me temë:
“Zhvillimi i zonave prioritare për
aplikimin Paketa e Maleve”**

Maj 2026

pranishëm! Ju falenderoj që jeni bërë pjesë të kësaj dëgjese publike. Qëllimi i kësaj dëgjese

është informimi mbi Paketën e Maleve. Ju fotj të dëgjojmë prezantimin nga ana e ekzekutivit dhe më pas presim pyetjet tuaja lidhur mbi këtë temë.

Kryetar i Bashkisë, z. Fation Duro— Përhëndetje të gjithëve! Qëllimi i këtij takimi është të informojmë mbi Paketën e Maleve dhe ju të shprehni interesin mbi këtë proces. Zona prioritare në Patos do të jenë të shtrira në komplet njësinë administrative Ruzhdie, Kuqarin.



**Kryetar i Bashkisë
z. Fation Duro**

Dëgjesë publike me temë:

**Dëgjesë publike me temë:
“Zhvillimi i zonave prioritare për aplikimin
Paketa e Maleve”**

Maj 2026

Në pjesën e dytë mund të shtohet dhe Rrerësi me Rusinjën. Ideja e Paketës së Maleve është që personat që janë posedues të tokës, por jo pronarë dhe që kanë marrë një tokë për ta zhvilluar në kuadër të turizmit mund të aplikoj në Paketën e Maleve dhe do të mund të kenë një mënyrë për ta zhvilluar me hapa shumë të shpejt. Kjo është një nismë e qeverisë që nga viti 2025. Kjo është një mënyrë që për ata persona që kanë një tokë që e posedojnë për më shumë se 10 vjet, të kenë mundësi për ta zhvilluar dhe përfutur tokën. 500 përfutuesit e parë janë të përjashtuar nga taksat. Nqse do të ketë pretendime nga dikush kur të fillojnë procedurat për të qënë pjese e Paketës së Maleve mbas miratimit të zonave prioritare, bëhet kërkesa, më pas shqyrtohet nga bashkia dhe Këshilli Bashkiak. Më pas hartohet Plani i investimeve nga personat që do përdorin këtë tokë, del leja përkatëse në Ministri dhe më pas dokumentacioni paraqitet për të bërë blerjen e tokës me vlerën prej 1 lekë. ASHK në momentin e miratimit të zonës prioritare në secilën bashki, fillon regjistrimin fillestar me procedura të përshpejtuara. Rishikohet dhe njëher harta dhe vazhdon procedura. Pra edhe njëherë kjo bëhet vetëm për toka që janë shtet dhe personi është posedues për një periudhë jo më pak se 10 vjet. Kjo vërtetohet nëpërmjet faturave tatimore, ortofotot e ndryshme që tregojnë zhvillimin e zonës, dhe mënyrave të tjera që tregojnë që kjo tokë ka qënë në përdorim të personit që aplikon. Duhet edhe vërtetim nga kryeplaku i zonës. Kjo pronë qëndron e afishuar rreth 45 ditë dhe nëse ka pretendime të tjera për atë tokë vendosen në dijeni.

Banor i Gjy노qarës, z. Ilir Dervishi– Përshëndetje! Si mund të aplikoj në Paketën e Maleve? A aplikoj dot unë që kam tokë këtu në Gjy노qarë që e përdor? Cilat zona mund të aplikojnë?



**Banor i Gjy노qarës
z. Ilir Dervishi**

**Dëgjesë publike me temë:
“Zhvillimi i zonave prioritare për
aplikimin Paketa e Maleve”**

Maj 2026

Kryetar i fshatit Gjy노qarë, z. Nuri Gllava- Si mund ta bëjmë aplikimin për Paketën e Maleve? A do kemi asistencë?



**Kryetar i fshatit Gjy노qarë
z. Nuri Gllava**

**Dëgjesë publike me temë:
“Zhvillimi i zonave prioritare për
aplikimin Paketa e Maleve”**

Maj 2026

Kryetar i bashkisë Patos, z. Fation Duro- Në qoftë se ke një tokë që e përdor për më shumë se 10 vjetësh dhe do ta zhvillosh duke hapur një fabrikë vaji apo diçka tjetër aplikon nëpërmjet e Albanias me dokumentacionin që kërkohet. 500 përfituesit e parë përjashtohen nga të gjitha taksat. Gjithmonë duke pasur një plan biznesi të saktë. Për të bërë certifikimin e tokës dhe për të ndërtuar diçka në mënyrë të ligjshmë është një mënyrë shumë e mirë. Zonat prioritare nuk janë miratuar akoma. Zonë interesi është e gjithë njësia Ruzhdie. Për aplikimin do të keni asistencë pranë bashkisë që t’u ndihmojë me aplikimin.



**Kryetar i bashkisë Patos
z. Fation Duro**

**Dëgjësë publike me temë:
“Zhvillimi i zonave prioritare për
aplikimin Paketa e Maleve”**

Maj 2026

Koordinator i Konsultimit Publik

Simela Shahinaj

Sekretar i Këshillit Bashkiak

Refaela Xeba